



Tax and Legal Alert

July 2021

PwC Albania - Tax and Legal Alert

July 2021

Korrik 2021

In this summary you will find the latest tax and legal changes which have been approved in Albania

Në këtë përmbledhje do të gjeni ndryshimet e fundit tatimore dhe ligjore të cilat janë miratuar në Shqipëri

On licenses, authorizations and permits

Për licencat, autorizimet dhe lejet

All businesses operating in the field of financial technology (Fintech) and ICT, providing services focused to financial markets based on Distributed Ledger Technology or Information Technology must get an operating license.

Të gjithë bizneset që ushtrojnë aktivitet në fushën e teknologjisë financiare (Fintech) dhe TIK, dhe ofrojnë shërbime të lidhura me tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë ose në fushën e teknologjisë së informacionit, duhet të pajisen me licencë operimi.

[Source: Law no. 72/2021 for an amendment to law no. 10 081, dated 23.2.2009, "On Licenses, authorizations and permits in the Republic of Albania", as amended].

[Burimi: Ligj nr. 72/2021 për një ndryshim në ligjin nr. 10 081, datë 23.2.2009, "Për Licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar].

On recording electronic invoice payments

Për regjistrimin e pagesave të faturave elektronike

Based on the addendum to the instruction of the Minister of Finance and Economy "On the registration of electronic invoice payments", electronic invoice payments issued before the total implementation of this law, which have not been reported in the tax administration by the banks or other non financial institutions, can be registered by the taxpayer who has issued the electronic invoice in his account on the central invoicing platform within the 10th of November 2021.

Në bazë të shtesës në udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë "Për regjistrimin e pagesave të faturave elektronike", pagesat e faturave elektronike të lëshuara përpara fillimit të plotë të efekteve të ligjit të cilat nuk janë raportuar në administratën tatimore nga banka ose institucioni tjetër financiar jobankar, mund të regjistrohen nga tatimpaguesi që ka lëshuar faturën elektronike në llogarinë e tij në platformën qendrore të faturave brenda datës 10 nëntor 2021.

[Source: Proposal of the General Directorate of Taxes, no. 10638, dt. 11.06.2021 "On the registration of electronic invoice payments"].

[Burimi: Propozim i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, nr. 10638, dt. 11.06.2021 "Për regjistrimin e pagesave të faturave elektronike"].

Non-fulfillment of the requirements of the law "On the invoice and the turnover monitoring system"

Për mospërbushje të kërkesave të ligjit "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit"

The Council Ministers decided to postpone the application of sanctions regarding the deadline for entry into force and implementation of the law "On Invoice and Turnover Monitoring System after January 1, 2022..

Këshilli i Ministrave vendosi të shtyjë zbatimin e sanksioneve në lidhje me afatet e hyrjes në fuqi dhe zbatimin efektiv të ligjit "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit" deri pas datës 1 janar 2022.

[Source: Normative act no. 27, dated 1.7.2021 For an addition to the law no. 9920, dated 19.5.2008, "On tax procedures in the Republic of Albania", amended "]

[Burimi: Akt normativ nr. 27, datë 1.7.2021 Për një shtesë në ligjin nr.9920, dt.19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar"]

Protocol of anti-COVID-19 measures throughout the tourist season

According to this protocol, all tourism enterprises, tourists, vacationers or visitors have the obligation to respect the rules provided in this protocol which are mainly related to:

- Informing tourists from tourism enterprises about anti-COVID-19 measures;
- Treatment of symptomatic cases;
- Undertaking necessary hygienic-sanitary measures during the process of registration and escort of visitors;
- Undertaking necessary general cleaning measures;
- Undertaking necessary measures related to general and food hygiene.

[Source: Joint Order of the Minister of Tourism and Environment and the Minister of Health and Social Protection no. 295, dated 18.6.2021 for the approval of the "Protocol of anti-COVID-19 measures during the tourist season"]

Announcements from the General Directorate of Taxes

Notice regarding the use of tax documentation

Based on the notification of the General Tax Directorate, the utilization of the existing tax documentation will continue until 31.08.2021 and the withdrawal of this documentation at the Regional Directorates can be done until 15.08.2021.

GTD encourages all taxpayers, who carry out cashless sale transactions and have not yet adapted (created) the necessary infrastructure for the Fiscalization process, to immediately perform the appropriate procedures, due to the legal obligation they have to fiscalize these transactions after 1 July 2021.

All taxpayers liable to implement the fiscalization process will issue only fiscalized invoices, and in case of technical problems, they will be provided with the necessary tax documentation from their respective RTD. For the purpose of recognizing expenses, tax invoices issued will continue to be recognized in cases where the implementation of the fiscalization process has not been implemented for reasons uncontrollable from the taxpayers.

Notice on the legal obligation to report bank accounts

Based on law no. 154/2020 "On the Central Register of Bank Accounts", the data carrier register has been established within the legal obligation of reporting bank accounts. Reporting data subjects include all financial institutions, banks and non-banks, which manage bank accounts and security tapes.

Financial institutions, which have not yet reported to the General Tax Directorate, failing to meet their legal obligations, will be subject to further penalties, according to the provisions of this law.

Protokolli i masave anti-COVID-19 përgjatë sezonit turistik

Sipas këtij protokollit, të gjitha sipërmarrjet turistike, turistët, pushuesit apo vizitorët kanë detyrimin të respektojnë rregullat e parashikuara në këtë protokoll të cilat lidhen kryesisht me:

- Informimin e turistëve nga sipërmarrjet turistike reth masave anti-COVID-19;
- Trajtimin e rasteve simptomatike;
- Ndërmarrjen e masave higjieno - sanitare gjatë procesit të regjistrimit dhe shoqërimit të vizitorëve;
- Ndërmarrjen e masave të përgjithshme të pastrimit dhe të lëvizjes;
- Ndërmarrjen e masave që lidhen me higjenën e përgjithshme dhe të ushqimit.

[Burimi: Urdhër i përbashkët i Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 295, datë 18.6.2021 për miratimin e "Protokollit të masave anti-COVID-19 përgjatë sezonit turistik"]

Njoftime nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

Njoftim në lidhje me përdorimin e dokumentacionit tatimor

Bazuar në njoftimin e Drejtorisë së Përgjithshme të tatimeve, përdorimi i dokumentacionit tatimor ekzistues do të vijojë deri në datën 31.08.2021 dhe tërheqja e këtij dokumentacioni nga tatimpaguesit, pranë Drejtorive Rajonale, do të mund të kryhet deri në datën 15.08.2021.

DPT Inkurajon të gjithë tatimpaguesit, që kryejnë transaksione shitjeje pa para në dorë dhe që nuk e kanë përshtatur (krijuar) ende infrastrukturën e nevojshme për procesin e Fiskalizimit, të kryejnë menjëherë procedurat e duhura, në bazë të detyrimit ligjor për t'i fiskalizuar këto transaksione pas 1 korrik 2021.

Të gjithë tatimpaguesit të cilët rezultojnë me zbatim efektiv të procesit të fiskalizimit do të lëshojnë vetëm fatura të fiskalizura, dhe nëse do të kenë probleme teknike, do të pajisen me dokumentacion tatimor në DRT e juridiksionit. Për efekt të njohjes së shpenzimeve faturat tatimore të lëshuara do të vijojnë të njihen për rastet kur zbatimi i procesit të fiskalizimit nuk është zbatuar për shkaqe të pavaruara nga tatimpaguesit.

Njoftim për detyrimin ligjor të raportimit të llogarive bankare

Bazuar në ligjin Nr. 154/2020 "Për Regjistrin Qendror të Llogarive Bankare", është ngritur regjistri mbartës i të dhënave në kuadër të detyrimit ligjor të raportimit të llogarive bankare. Subjekte raportuese të të dhënave janë të gjitha institucionet financiare banka dhe jo banka, të cilat kanë në administrimin e tyre llogari bankare dhe kasete sigurie.

Institucionet financiare, të cilat ende nuk kanë raportuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, duke mos përmbushur detyrimet e tyre ligjore, do të jenë subjekt për penalitete të mëtejshme, sipas dispozitave që parashikon ky ligj.



Let's talk!

For further information, please contact:

PricewaterhouseCoopers Albania
Str. "Ibrahim Rugova", Sky Tower, 9/1

Telephone: +355 4 22 90 700

Email: al_pwc_albania@pwc.com

Web: www.pwc.com/al

